



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Dhjetor, 2022

Takimi përmbyllës me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve
**I propozohet BSPK-së ta mbyll grevën e pezulluar më
1 tetor**



Në përmbyllje të vitit 2022, SBASHK-u ka mbajtur takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Fillimisht janë takuar anëtarët e kryesisë dhe të Këshillit Grevist dhe kanë analizuar situatën aktuale. Duke u nisur nga fakti se Ligji i pagave është votuar nga Parlamenti dhe pritet të nis implementimi i tij në shkurtin e vitit 2023 e që ishte kërkesë kryesore e SBASHK-ut, Kryesia dhe Këshilli Grevist kanë dalë para kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të Universiteteve me propozimin që...(faqe 5)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vizituan Kuvendin Komunal të Kaçanikut
Takim me kryetarin Besim Ilazi dhe drejtorin e arsimit Zahir Doda

Në kuadër të vizitës në Kaçanik për të marrë pjesë në Kuvendin ...(faqe 6)

Flasin anëtarët e stafit qendror të SBASHK-ut
Do të vazhdojmë angazhimet në shërbim të anëtarësisë
Ymer Ymeri



Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, viti 2022 për të gjithë ne ishte i vështirë e ...(faqe 3)

Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Kaçanik
Kryetar u zgjodh Islam Berisha



Në ambientet e Gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik është mbajtur Kuvendi zgjedhor i ...(faqe 5)

Mirënjohje domethënëse për SBASHK-un
Gazeta “Nacionale” kryetarin Jasharaj e shpalli personalitet të vitit



SBASHK-u është ndierë mirë me këtë vendim të gazetës Nacionale dhe e falënderon ...(faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Dhjetori e solli Ligjin e pagave



Pas një rrugëtimi të gjatë e përpjekjeve të shumta të SBASHK-ut dhe sindikatave tjera besojmë se pritjeve ju erdhi fundi sepse Parlamenti i Kosovës votoi Ligjin e pagave. Bazuar në atë që është thënë dhe në tabelorët e koeficienteve vërehet se janë përfshirë shumica e propozimeve të SBASHK-ut dhe besojmë se Qeveria do të shpall se shpejti edhe vlerën e koeficientit, i cili do të qartësojë çdo gjë dhe do të dihen edhe pagat në tërë sektorin e arsimit, por edhe për të punësuarit në sektorët tjerë. Jemi të bindur se koeficientet e paraparë në këtë Ligj do të bëjnë edhe ngritje pagash, kërkesë kjo legjitime e të gjithë të punësuarve në sektorin publik, aq më shumë

pasi për disa vite me radhë nuk ka pasur lëvizje pozitive të pagave. Urojmë që gjërat të shkojnë mbarë me Ligjin e pagave e pastaj SBASHK-u do të vazhdojë rrugëtimin duke u angazhuar për kushte më të mira të punës në institucionet arsimore, por edhe do të ngrit në takimet me institucionet kërkesat e arsyeshme që do të vijnë nga anëtarësia. Urojmë që viti 2023 për të gjithë ne të sjell më shumë lajme të mira e më pak sfida.

Për të mos i lënë në harresë angazhimet, sfidat dhe arritjet e vitit 2022 stafi qendror i SBASHK-ut i ndihmuar edhe nga kryetarët ve nivelit komunal dhe të Universiteteve ka përgatitur dhe do ta botojë revistën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2022”.

Stafi qendror i uron gjithë anëtarësisë Gëzuar vitin 2023 me lutjen që të kemi shumë gëzime familjare e arritje të shumta në punë e në aktivitete sindikale.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Flasin anëtarët e stafit qendror të SBASHK-ut
Do të vazhdojmë angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Ymer Ymeri

Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, viti 2022 për të gjithë ne ishte i vështirë e me plot sfida. Duke respektuar vullnetin tuaj dhe kërkesat legjitime kemi bërë gjithë angazhimet që të jemi


në krye të detyrës. Bashkërisht arritëm të kryejmë me sukses detyrat e përcaktuara. Kemi realizuar edhe trajnimet sipas kërkesave tuaja, por bashkë ishim shembull i mirë edhe i realizimit të aktiviteteve për të shënuar ditën e madhe të mësuesit e shkollës shqipe, për të pasur rrjedhë të mbarë aktiviteti i bërë tradicional për pushimin e një numri të konsideruar të anëtarësisë së SBASHK-ut në bregdetin shqiptar. Po ashtu gjatë gjithë vitit kemi vazhduar i tërë stafi bashkë me kryetarin dhe nënkryetaren që të jemi zë i juaji kurdo e kudo në takimet me institucionet vendore, por edhe në aktivitetet ndërkombëtare sindikale. Ju përgëzojmë për unitetin dhe qëndrimin e dinjitetshëm në gjithë aktivitetet e angazhimet për realizimin e detyrave të përbashkëta dhe të kërkesave legjitime. Urojmë që në vitin 2023 të marrim lajme të mira dhe të shënojmë arritje të reja.



Afërdita Ahmeti

Edhe gjatë gjithë këtij viti stafi qendror ka treguar një unitet të shkëlqyer dhe gjithmonë i jemi gjendur njëri-tjetrit për ta ndihmuar me qëllim që obligimet që kishim për realizimin e kërkesave të anëtarësisë t'i

kryejmë me kohë dhe në nivel të duhur. Kjo atmosferë bashkëpunimi na ndihmoi të tejkalojmë sfidat e shumta me të cilat ne dhe ju u përballëm gjatë gjithë vitit 2022. Jemi munduar që të jemi korrekt me ju edhe gjatë vizitave që bënit në zyrat tona duke kërkuar ndihmën e përkrahjen tonë. Besojmë se ia kemi arritur të jemi në nivel të detyrës dhe ju falënderojmë për korrektësinë e mirëkuptimit tuaj. Lutemi bashkërisht që viti që po vjen të jetë me plot lajme të mira e me arritje të shumta.



Albina Arifi

Anëtarësi e nderuar e SBASHK-ut ishte kënaqësi për mua kur arrinim të organizonim si duhet aktivitetet e trajnimeve. Unë ndjem krenare me ju dhe ju falënderoj për bashkëpunimin dhe angazhimin e


korrektësinë e treguar gjatë gjithë ditëve të këtij aktiviteti duke qenë pjesë e të tetë trajnimeve të licencuara. Stafi qendror i tëri ishte i përkushtuar e i angazhuar, krahas detyrave të tjera në të njëjtën përpjekje e kur kishte shumë grupe të trajnimeve në të njëjtën kohë që ky aktivitet të kishte rrjedhë të mbarë dhe besoj se bashkërisht edhe ia kemi arritur. Bashkërisht e me plot suksese do të vazhdojmë edhe në vitin 2023, por edhe në gjithë vitet tjera.



Vlora Rexhepi Berisha

Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë kudo jeni, ju përsëndes me urimin më të sinqertë që viti 2023 të na sjellë lajme të mira, shumë suksese e arritje në rrugëtimin tonë të përbashkët. Ne stafi qendror duke u angazhuar

bashkërisht u munduam të jemi në krye të detyrës dhe të realizojmë kërkesat tuaja sindikale. Me kënaqësi po përmend se edhe gjatë gjithë vitit 2022 kemi pasur komunikim e bashkëpunim të shkëlqyer me sindikatat simotra dhe me Komitetin e Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe me Internacionalen e Arsimit (EI) dhe nga ata kemi pasur mbështetje të vazhdueshme për t'u përballur më lehtë me sfidat e shumta të kohës. Urojmë bashkërisht që viti 2023 të jetë me plot arritje e suksese për të gjithë ne.



Nezafete Jakupi

Ishte ky një vit i vështirë për të gjithë ne. Falë unitetit dhe bashkëpunimit me ju të nderuar anëtare e anëtarë dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin në stafin qendror,

besoj se ia kemi arritur suksesshëm t'ia dalim në realizimin e detyrave tona të përditshme në shërbim të anëtarësisë. Isha e nderuar me komunikimin që kisha me ju dhe u mundova me tërë mundësitë që të realizoj me kohë gjithë kërkesat nga vendi im i punës. Ndjem krenare që jam njëra nga anëtarët e SBASHK-ut dhe që jam pjesë e stafit qendror, i cili edhe në vitin 2023, por edhe në gjithë vitet e ardhshme do të jetë në nivel të detyrës në përpjekje për realizimin e detyrave konkrete në shërbim të anëtarësisë.



Blendor Shatri

Edhe në vitin 2022 kam bërë gjithë angazhimet për t'u dhënë këshilla juridike e për t'u përgatitur edhe shkresa të duhura gjithë anëtarëve të SBASHK-ut që kanë kërkuar një angazhim të tillë. Jam ndjerë mirë kur kam arritur t'u dalë në ndihmë veçmas anëtarëve të

SBASHK-ut që janë në moshë më të shtyrë e që vinin të këshilloheshin e të merrnin shkresat e duhura për të arritur të realizonin të drejtat e siguruara nga Kontrata Kollective e Arsimit. Po ashtu jam ndjerë krenar kur kam prezantuar në mënyrë të suksesshme SBASHK-un në takime të komisioneve të ndryshme dhe në kuadër të aktiviteteve të BSPK-së. Ky vit ishte me plot sfida për të gjithë ne, por është kënaqësi dhe njeriu ndihet mirë kur komunikon drejt me palët dhe ata kthehen nga selia e SBASHK-ut me përshtypje të mira dhe këtë e thonë kudo në bashkëbiseda me të tjerët. Urojmë që viti 2023 të na sjell më pak sfida e shumë më tepër të na sjell lajme të mira, suksese e arritje të reja.



Vjollca Shala

Ndjem e nderuar që Këshilli Drejtues më votën e lirë e të fshehtë më dha besimin që edhe për një mandat të jem nënkryetare e SBASHK-ut. Ky besim më ka obliguar që të vazhdoj me angazhimet e përkushtimin në realizim të detyrave konkrete gjatë gjithë

vitit. Jam munduar që SBASHK-un ta prezantoj në mënyrë të denjë në takimet me institucionet, në tryeza e Konferenca të organizuara në Kosovë, por edhe në aktivitetet ndërkombëtare sindikale. Me të gjitha mundësitë jam munduar ta përkrah edhe stafin qendror që ka bërë angazhime maksimale në realizimin e detyrave të përditshme. Uroj që për të gjithë ne viti 2023 të na sjell momente gëzimi dhe të jetë vit i arritjeve e sukseseve në SBASHK.



Rrahman Jasharaj

Edhe në momentet kur individë që u mungon njerëzorja u munduan të më lëndojnë me fyerje e shpifje jam ndjerë i fortë dhe kam vazhduar rrugëtimin e nisur. Këtë forcë e mbështetje e gjeta gjithmonë te stafi qendror, te kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve dhe të e gjithë anëtarësia. Jam krenar me SBASHK-un sepse anëtarësia kudo në Kosovë që nga çerdhet e në Universitete dhe institucione të kulturës u përballën me dinjitet me furtunat duke ruajtur unitetin dhe besimin e ndërsjellë. Furtunat ishin të shpeshta, por ne të gjithë e kudo jemi mbetem bashkë e në SBASHK. Anëtarësi e nderuar e SBASHK-ut, të lutemi bashkë që viti 2023 të na sjell gëzime në familjet tona dhe suksese e arritje në sindikatën tonë.

Gjatë muajit

Takimi përmbyllës me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve **I propozohet BSPK-së ta mbyll grevën e pezulluar më 1 tetor**

Në përmbyllje të vitit 2022, SBASHK-u ka mbajtur takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Fillimisht janë takuar anëtarët e kryesisë dhe të Këshillit Grevist dhe kanë analizuar situatën aktuale.



Duke u nisur nga fakti se Ligji i pagave është votuar nga Parlamenti dhe pritet të nis implementimi i tij në shkurtin e vitit 2023 e që ishte kërkesë kryesore e SBASHK-ut, Kryesia dhe Këshilli Grevist kanë dalë para kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të Universiteteve me propozimin që SBASHK-u t'i drejtohet BSPK-së që të merret vendim për mbylljen e grevës së pezulluar më 1 tetor 2022. Këtë propozim pjesëmarrësit e këtij takimi e kanë aprovuar unanimisht pas diskutimeve që janë zhvilluar lidhur me këtë çështje.

Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Kaçanik **Kryetar u zgjodh Islam Berisha**

Në ambientet e Gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik është mbajtur Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Ky kuvend u mbajt për të bërë zgjedhjen e kryetarit të ri pasi kryetari Fevzi Bunjaku pas viteve e dekadave të kaluara në misionin e shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave dhe në aktivitetet sindikale u pensionua.



Pas kësaj kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë marrë nga një ekzemplarë të revistës vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2022” për secilën shoqatë sindikale në komunat e tyre, gjegjësisht në Universitete.



Në këtë takim u mor vendim që të përgatitet një agjendë e takimeve nëpër komuna dhe Universitete, e cila do të nis se realizuari nga janari i vitit 2023.

Kryetari Bunjaku në hapje të këtij Kuvendi zgjedhor ka përshëndetur të pranishmit dhe ka falënderuar kryetarin Rrahman Jasharaj dhe koordinatoren për organizim të brendshëm në SBASHK Ymer Ymeri për praninë e tyre në këtë takim. Ai pastaj ka shpalosur pjesë nga raporti i punës duke u ndalur në momentet e veçanta të angazhimeve sindikale në shërbim të anëtarësisë.



Ai ka falënderuar kryesinë e veprimtarët tjerë në Kaçanik për realizimin e aktiviteteve në shërbim të anëtarësisë. Po ashtu kryetari Bunjaku ka shprehur respekt për gjithë bashkëpunimin e përkushtimin e stafit qendror të SBASHK-ut.



Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar të pranishmit për angazhimet e unitetin dhe ka shprehur respekt meritë për kryetarin Bunjaku, i cili ka qenë vazhdimisht i përkushtuar në angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.

Kryetari Bunjaku pa prezantuar edhe raportin financiar, i cili është aprovuar. Pas kësaj pjesëmarrësit kanë formuar komisionin zgjedhor dhe përmes votës së fshehtë e në garën mes dy e më shumë kandidatëve kryetar i ri i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Kaçanikun u zgjodh Islam Berisha. Kolegu Berisha falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë duke u shprehur i sigurt se bashkërisht do të vazhdojnë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Mirënjohje domethënëse për SBASHK-un Gazeta “Nacionale” kryetarin Jasharaj e shpalli personalitet të vitit



SBASHK-u është ndierë mirë me këtë vendim të gazetës Nacionale dhe e falënderon gazetën në fjalë, e cila tha: “Rrahman Jasharaj nuk ka qenë kurrë më i urryer dhe më i dashur në Kosovë, megjithëse aktiviteti i tij sindikal shtrihet në tri dekada. Arsimitari nga Dukagjini

ka mbetur i lidhur me profesionin e tij, kolegët e punën e tij. Ai rezononte çiltërsi e autenticitet, dhe merrej vesh edhe nga mënyra se si thurte fjalitë që s’i merrte vesh lojërat e ndyra të politikës tonë ditore. Jasharaj nuk kërkonte as dashuri e as urrejtje. Kërkonte pagë të dinjitetshme për punëtorët e arsimit në një kohë rritjesh të çmimeve që po varfëronte pamëshirë. S’e kërkonte asnjë cent më shumë për veten e tij. Po i kërkonte 100 euro më shumë për mësimdhënësit. Po i kërkonte deri në miratimin e Ligjit të Pagave.”

Me këtë vendim të gazetës Nacionale janë ndierë mirë e gjithë anëtarësia e SBASHK-ut e cila me anë të mesazheve i kanë shpreh urimet më të mira kryetarit Jasharaj, i cili i falënderon për përgëzimet: “Të nderuara kolege, të nderuar kolegë ju faleminderit për përgëzimet. Te personaliteti i vitit është emri im, por këtë titull e meritoni ju bashkë me mua. Bashkë e në SBASHK.”

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vizituan Kuvendin Komunal të Kaçanikut Takim me kryetarin Besim Ilazi dhe drejtorin e arsimit Zahir Doda



Në kuadër të vizitës në Kaçanik për të marrë pjesë në Kuvendin zgjedhor të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Kaçanikun Fevzi Bunjaku kanë vizituar Kuvendin Komunal dhe janë takuar me kryetarin Besim Ilazi dhe me drejtorin e arsimit Zahir Doda.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar kryetarin Ilazi për pritjen dhe për bashkëpunimin korrekt me sindikatën tonë në këtë komunë. Ata janë shprehur të sigurt se edhe pas zgjedhjes së kryetarit të ri të

Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Kaçanik bashkëpunimi do të vazhdojë në angazhimet e përbashkëta në shërbim të arsimit në këtë komunë. Kryetari Jasharaj në këtë bashkëbisedë ka përshëndetur mikpritësit duke i falënderuar për bashkëpunimin dhe pastaj është shprehur se kolegu Fevzi Bunjaku është shembull i mirë i përkushtimit e angazhimit misionin e shenjtë në arsimimin dhe edukimin e brezave, por edhe në aktivitetet sindikale.

Kryetari i Kaçanikut z. Besim Ilazi ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën duke u shprehur i bindur se edhe në të ardhmen ai bashkë me drejtorin e

arsimit do ta vazhdojnë bashkëpunimin me sindikatën në shërbim të arsimit.



Përgjegjësi i Qendrës së Solidaritetit vizitoi SBASHK-un Mbështetje në angazhimet e SBASHK-ut



Përgjegjësi i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë z. Steven McCloud ka vazhduar me angazhimet me qëllim të shtimit të bashkëpunimit të sindikatave të arsimit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova dhe pas një takimi konsultativ në Ohër me përfaqësues të këtyre sindikatave ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe ka zhvilluar një takim përmbajtësor me kryetarin Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar z. McCloud për vizitën dhe angazhimin

e tij të vazhdueshëm që të ketë në atë ardhmen aktivitete të përbashkëta mes sindikatave të këtyre tri shteteve. Ata i kanë treguar mysafirit të nderuar se kanë bashkëpunim të shkëlqyer me shumë nga sindikatat e shteteve të Ballkanit e Evropës, por tani e shumë vite kanë bashkëpunim të shkëlqyer edhe me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës AFT. Ata pastaj kanë informuar z. McCloud për situatën aktuale në arsimin e Kosovës, për angazhimet në shërbim të anëtarësisë, por edhe për sfidat e shumta me të cilat janë përballur në gjatë vitit 2022.

Përgjegjësi i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë z. Steven McCloud ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe është shprehur se në të ardhmen do të ketë angazhime të përbashkëta sindikale mes sindikatave të arsimit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova me qëllim të bartjes së përvojave të njëra-tjetra dhe zhvillimit të tryezave e trajnimeve për çështje arsimore e sindikale.

SBASHK-u ndjehet i nderuar AVONET mirënjohje të veçantë për kryetarin Jasharaj



Në ambientet e restorant “Natyral” në fshatin Sojevë të Ferizajt, Rrjeti i Organizatave Joqeveritare “AVONET” ka mbajtur takimin përmbyllës për vitin 2022.

Pasi ka prezantuar para veprimtarëve e mysafirëve të shumtë angazhimet dhe arritjet e shumta të AVONET në këtë vit, drejtori ekzekutiv Kenan Gashi ka deklaruar se ky

rrjet do të ndaj edhe mirënjohje të veçanta për individë që u dalluan me angazhime gjatë këtij viti. Ai pastaj ka ftuar dhe i ka ndarë mirënjohje të veçantë edhe kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj me motivacionin “Në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për ngritjen e vetëdijes në respektimin e të drejtave të punëtorëve.”

SBASHK-u ndjehet i nderuar me këtë mirënjohje për kryetarin Jasharaj.



U përgatit për botim revista “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2022”

Kujtesë për angazhimet dhe sfidat e kohës

Stafi qendror i SBASHK-ut i ndihmuar edhe nga kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve ka vite që përgatitin dhe botojnë revistën që pasqyron rrugëtimin e SBASHK-ut brenda një viti. Duke vazhduar këtë traditë ata edhe këtë vit përgatiten shkrime të shumta, të cilat shpalosin kujtimet për ngjarjet, sfidat, angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut duke filluar nga muaji janar e deri te muaji dhjetor.

“Rrugëtimi i SBASHK-ut 2022” do të jetë në duart e lexuesve dhe do t’u mundësojë që të kthejnë kujtesën për një numër të madh të aktiviteteve e përpjekjeve sindikale në nivel vendi dhe në atë ndërkombëtar. Janë aty edhe momente plot sfida të përpjekjeve për takime me institucionet e për të gjetur zgjidhje për kërkesat legjitime. Janë aty edhe shkrimet që kujtojnë veprimet sindikale si shkak i mungesës së gatishmërisë së Qeverisë dhe institucioneve për dialog.

Stafi ka punuar me përkushtim që të përfshihen ngjarjet kryesore e që revista të jetë sa më e kompletuar. Mund të na ketë ikur edhe ndonjë gabim teknik a drejtshkrimor dhe për këtë ju kërkojmë falje lexuesve .

